

TIPARET E SIGURISË

SERIA EUROPA

€ 200



NDJEJE



SHIKOJE



LËVIZË



KONTROLLOJE



KONTROLLOJE

PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Dizajni i kartëmonedhës
- Tiparet e sigurisë
 - Letra e kartëmonedhës
 - Shtypi me relief
 - Shenja ujore me portret
 - Numri ngjyrë smeraldi
 - Shiriti metalik
 - Shiriti i sigurisë
 - Simbolet ne shiritin metalik
 - Nën dritën Ultra Violete (UV)
 - Mikroshtypi

HYRJE

Kartëmonedhat Euro janë prodhuar me një teknologji të sofistikuar të shtypjes. Ato përbajnjë disa veti të sigurisë, të teknologjisë më të lartë. Kjo i bën ato të dallohen lehtë nga ato të falsifikuara. Juve nuk ju duhet ndonjë mjet special. Në fakt, e tëra ajo që duhet të bëni është ta NDJENI, SHIKONI dhe ta LËVIZNI kartëmonedhën.

Ashtu sikurse tek seria e parë të kartëmonedhave euro, edhe tek seria e re Europa kontrollimi i tipareve të sigurisë do të jetë i lehtë duke përdorur metodën "NDJEJE, SHIKOJE dhe LËVIZE". Nuk nevojiten mjete speciale për këtë gjë.

Seria e re e kartëmonedhave do të quhen seria Europa për shkak se disa nga tiparet e tyre të sigurisë do të përbajnjë një portret të Europa-s, një figurë e mitologjisë Greke nga rrjedh edhe origjina e emrit të kontinentit tonë.

Kartëmonedhat e reja përbajnjë tipare të avancuara të sigurisë.

Gjithmonë kontrolloni disa veti.

Nëse ende jeni të pasigurte, krasojeni kartëmonedhën me një që jeni i sigurt se është e vërtetë. Ky manual tregon dhe sqaron vetitë e sigurisë së kartëmonedhës prej 200€.

DIZAJNI I KARTËMONEDHËS

Elementet kryesore te kartëmonedhës ne vlerë prej 200€ janë:

- Ura, që paraqet njëren prej periudhave historike arkitekturale të Evropës (pjesa e prapme e kartëmonedhës)
- Dritaret ose dyert që simbolizojnë shpirtin e hapur dhe bashkëpunimin në Evropë (pjesa e përparme e kartëmonedhës)
- Emri i valutës i shkruar në alfabetin latin (EURO), atë grek (ΕΥΡΩ) dhe atë cyrillic (EBPO).
- Flamuri i Bashkimit Evropian.
- Simboli © shenjë për mbrojtjen e të drejtës së autorit
- Inicialet e Bankës Qendrore Evropiane në nëntë variante të ndryshme gjuhësore: BCE, ECB, ЕЦБ, EZB, EKP, EKT, EKB, BCE dhe EBC.
- Nënshkrimi i presidentit të Bankës Qendrore Evropiane. Kartëmonedhat EURO të serisë Europa mbartin nënshkrimin e Mario Draghi, Kryetarit të tretë ose të Christine Lagarde Kryetarit të katërt të Bankës Qendrore Evropiane .



€200

Madhësia: 153 x 77 mm

Ngjyra: Okër

Periudha arkitekturale: Hekur dhe xham

TIPARET E SIGURISË

Kartëmonedhat e serisë së re Europa përmbajnë tipare të avancuara të sigurisë. Karakteristikat e reja të sigurisë të serisë së re është që do t'ë jenë të lehta përfshirë tu gjetur në kartëmonedha.

Që t'ë verifikoni se a është kartëmoneda origjinale, e tëra ajo që duhet të bëni është ta NDJENI, SHIKONI dhe LËVIZNI atë.

Tiparet kryesore të sigurisë së kartëmonedhave euro janë:

- Letra e kartëmonedhës
- Shtypi me relief
- Shenja ujore me portret
- Numri ngjyrë smeraldi
- Shiriti metalik
- Shiriti i sigurisë
- Simbolet ne shiritin metalik
- Nën dritën Ultra Violete (UV)
- Mikroshtypi



LETRA E KARTËMONEDHËS



Letra e kartëmonedhës
është e tëra pambuk i
pastër, e qëndrueshme
dhe e fortë (jo e butë dhe e
lëmuar).





NDJEJE

SHTYPI ME RELIEV



Shtypja speciale me gdhendje është e pranishme në formë të vijave tek skajet e përparme të kartëmonedhës, pastaj tek inicialet e Bankës Qendrore Evropiane në nëntë variante të ndryshme gjuhësore (ne anen e majtë), në vlerën numerike dhe në porten e kartëmonedhës.

Që të ndjeni reliefin e shtypur, prekni me gisht figurat ose gërvisheni lehtë me thonj.





SHENJA UJORE PORTRET




Shenja ujore paraqitet kur e mban kartëmonedhën lart kundrejt dritës.

Kalimi në mes të pjesëve të ndritshme dhe të errësuara të shenjës ujore është i butë.

Mbajeni kartëmonedhën në një pjesë të errët dhe pjesët e ndriçuara bëhen më të errta. Ky efekt lehtë mund të vërehet në imazhin e Europes dhe numrin e shenjës ujore.

Shenja ujore është prodhuar duke ndryshuar trashësinë e letrës





NUMRI NGJYRË SMERALDI



Kur ta LEVIZNI kartëmonedhën, numri shkëlqyes tregon një efekt lëvizës të dritës që lëviz lartë-poshtë dhe e kundërtë poshtë-lartë.

Numri gjithashtu ndryshon ngjyrën nga e gjelbër smerald në të kaltër të mbyllët.




SHIRITI METALIK



Kur ta LËVIZNI
kartëmonedhën, në pjesën
e lartë shfaqet tipari i
satelitit ku dy simbole të €
orbitojnë rreth numrit të
vlerës.

Nëse e LËVIZNI
kartëmonedhën kundër
dritës - dritarja në shirit
bëhet transparente dhe
zbulon një portret të
Evropës në të dy anët e
kartëmonedhës..



SHIRITI METALIK - SIMBOLET



Kur ta LEVIZNI kartëmonedhën, shiriti i argjendit tregon portretin e Europes. Shiriti gjithashtu tregon porten, vlerën e kartëmonedhës dhe simbolin €.






SHIRITI I SIGURISË



Shiriti i sigurisë është i futur në brendësi të letrës së kartëmonedhës. Mbajeni kartëmonedhën kundrejt dritës – dhe shiriti do te duket i errësuar. Simboli € dhe vlera e kartëmonedhës do të shihen me shkronja të vogla në shirit.





NËN DRITËN UV



- Letra në vetvete nuk shkëlqen;
- Fijet e futura në letër shfaqen. Secila fije shfaqet me 3 ngjyra.
- Yjet ne flamurin e BE-së, rrathet e vegjel dhe yjet e mëdhenj shkelqejne me ngjyre të verdhë.
- Ne pjesen e prapme nje e katerta e pjesës së rrithit ne qender shkelqen me ngjyre te gjelbër.
- Numri serik dhe shiriti shkelqyes behen te kuq.





MIKROSHTYPI



Në vende të ndryshme të kartëmonedhës mund të vëreni karaktere të imta, **EURO200EYPΩ200EBPO200** në pjesën e përparme tek yjet dhe dritarja si dhe tek ura në pjesën e prapme të kartëmonedhës .

Nevojitet qelqi zmadhues për të parë mikroshtypin.

Mikroshtypi tek kartëmonedhat e vërteta është i qartë (jo i mjequlluar).



